



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 7 Prot.

Tiranë, më datë 15.01.2024

VENDIM  
Nr. 5, datë 15.01.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 15.01.2024:

VENDOSI:

- Miratimin e Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik Sipërfaqësor në kuadër të projektit “Kompleks banimi dhe shërbimesh 1, 2, 3 me 1 dhe 2 kat nëntokë me mur rrethues dhe pishina, në pasuritë me nr. 397/14, 397/13, 397/7, 397/9, 397/51, 397/4, 396/1, 396/2, 406/10, 406/3, Zona Kadastrale 1605, në Njësitë Strukturore FA/80, FA/81, FA/78, FA/127, Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë, në pronësi të Geront Çela, Bledar Çela, Ulsi Manja, Ermira Manja, Mehmet Kurti, Brunet “sh.p.k.”, me zhvillues Casa Del Lago sh.p.k.”, hartuar nga subjekt i licencuar në arkeologji znj. Iris Pojani, me aplikues “SON Engineering Construction” dhe zhvillues CASA DEL LAGO sh.p.k.;
- Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje rastësore, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohen pranë IKTK-së, sipas Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 145 - 147;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
- Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Klesta QIRICI

KRYETAR

Elva MARGARITI

